



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Korçë, më datë 31/10/2025

BASHKIA KORÇË

Proces-verbal

Bazuar në Ligjin Nr 139/ 2015, neni 3, pika “dh”, në datat 15 Shtator – 17 Shtator 2025 në kuadrin e procesit të “Buxhetimit me Pjesëmarrje”, për të diskutuar lidhur me kërkesa dhe shqetësime të kryetarëve dhe banorëve të fshatrave si dhe Paketën Fiskale 2026, u zhvilluan takime të njëpasnjëshme me kryetarët e Njësi Administrative të Bashkisë Korçë, si edhe me banorë të çdo njësie.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin Z. Sotiraq Filo Kryetar Bashkia Korçë, Z. Kletjon Kita Zv.Kryetar Bashkia Korçë, Soniel Prifti Drejtor i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Korçë, Marenglen Hoxhalli Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Ndriçim Hoxha Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës, përfaqësues të Këshillit Bashkiak.

Fjalën e mori i pari Z. Sotiraq Filo, i cili listoi disa nga investimet e mëdha të realizuara por edhe në proces në njësitë administrative. Mes tyre përmendi projektet: përmirësimi i infrastrukturës rrugore në disa fshatra të Bashkisë Korçë, ndërhyrjet e njëpasnjëshme në rrugët e parcelave në të gjithë fshatrat e bashkisë, ndriçimin publik, rikonstruktimin e qendrave të fshatit etj. Në vazhdim ai foli edhe për rëndësinë e marrjes së mendimeve të kryetarëve dhe banorëve të fshatrave për investimet gjatë vitit të ardhshëm në mënyrë që t’u jepet prioritet atyre ndërhyrjeve që vetë ata i shohin si më emergjente.

Pasi u njohën me shpjegimet përkatëse për “Buxhetimin me Pjesëmarrje” dhe mundësinë që ata kanë për të zgjedhur vetë ato ndërhyrje që bashkia duhet t’i shohë me përparësi, kryepleqtë patën mundësinë për të parashtruar kërkesat e tyre dhe për të vendosur prioritetet sa i takon fokusit të investimeve të Bashkisë Korçë për vitin 2026. Kërkesat e tyre u mbajtën shënim paralelisht dhe të detajuara sipas grafikut të takimeve të zhvilluara më poshtë:

Takimet e zhvilluara:

- 15 Shtator - Njësia Administrative Drenovë
- 15 Shtator- Njësia Administrative Vithkuq
- 16 Shtator- Njësia Administrative Voskop
- 16 Shtator - Njësia Administrative Bulgarec
- 17 Shtator- Njësia Administrative Voskopojë dhe Lekas
- 17 Shtator- Njësia Administrative Mollaj

Bazuar në kërkesat e ngritura nga kryetarët dhe banorët e fshatrave u listuan nevojat e tyre si më poshtë:

DRENOVË

- **Fshati Drenovë:** Problem me fundoret e ujërave të zeza, rikonstruksioni i çezmës së fshatit, shtimi i sipërfaqes së varrezave.
- **Fshati Boboshticë:** Kërkesë për shtimin e tubacionit të ujërave të zeza, sistemimin e kanaleve, rritjen e investimeve nga UKKO.
- **Fshati Turan:** Problem me mungesën e ujit për vaditje. asfaltimin e rrugëve brënda fshatit, zgjerimi i shkollës, rikonstruksioni i qendrës shëndetësore.
- **Fshati Dardhë:** Rikonstruksioni i kalldrëmëve ne qendër të fshatit, sistemimi i ujërave të zeza.
- **Fshati Ravonik:** Ndërhyrje në infrastrukturën e fshatit, vijëzimin e rrugës së re dhe vendosja e tabelave për kufizim shpejtësie.

- **Fshati Moravë:** Kërkesë për asfaltimin e rrugës pasi ai egzistues është dëmtuar.

Kryelaku i fshatit Boboshticë

- Kërkojmë nga UKKO që të investojë në rrjetin e ujësjellësit të fshatit pasi fshati nuk ka ujë
- Kërkojmë të shtrohen tubacionet e ujërave të zeza, dhe të bëhet sistemimi i kanaleve.
- Në lagjen e Manastirit duhet të rikonstruktohet rruga duke ruajtur identitetin e kalldrëmit.
- Kërkojmë asfaltimin e rrugës që nga qendra e fshatit deri tek tavernat
- Kërkojmë nga UKKO administrim më të mirë të ujit të pishëm pasi janë krijuar shumë lidhje të paligjshme që shpërdorjnë ujin dhe fshati mbetet pa ujë.

Kryelaku i fshatit Turan

- Fshati Turan gjithmonë ka pasur problem me ujin e vaditjes së tokave dhe nuk po merr akoma një zgjidhje.
- Rruget e fshatit duhet të asfaltohen.
- Shkolla e fshatit duhet të zgjerohet dhe të rikonstruktohet pasi ka femijë por ambientet janë shumë të pamjaftueshme, tualetet janë jashtë funksionit pasi mungon edhe uji.
- Qendra shëndetësore duhet të rikonstruktohet.
- Kulla që është e vendosur në qendër të fshatit rrezikon të bjerë pasi është e amortizuar duke vënë në rrezik banorët.
- Linjat e tensionit të energjisë elektrike kalojnë nëpër degët e pemëve dhe në ditët që fryn ere ose bie shi rryma elektrike shkarkon në tokë.
- Kërkojmë ndërtimin e lulishtes në qendër të fshatit.

Kryelaku i fshatit Drenovë

- Kanalizimet që janë lënë përgjysëm kërkojmë të perfundohen.
- Problem me UKKO pasi nuk ka kontrole nga ana e ndërmarrjes dhe ka shumë lidhje të paligjshme.
- Kemi problem me papastërtinë të ujit, uji vjen me mbeturina dhe nuk e dimë nëse behet ndonjëherë dezinfektim.
- Kërkojmë mirëmbajtjen e sheshit të fshatit.

Kryeplaku i fshatit Dardhë

- Kërkojmë rikonstrukcionin e kalldrëmeve në qendër të fshatit pasi janë dëmtuar.
- Kërkojmë sistemimin e ujërave të zeza.
- Depoja e ujit të dezinfektohet më shpesh.
- Kërkojmë sistemimin e avllive të cilat janë në tokë shtet (ledhi i rrugës)
- Kërkojmë që makina e cila mbledh mbeturinat në fshat të vijë më shpesh

Kryeplaku i fshatit Ravonik

- Kemi problem me vaditjen e tokave, uji i vaditjes gjatë verës nuk vjen.
- Kërkojmë shtrimin e një segmenti rrugor e cila ka mbetur e pa shtruar.
- Rikonstrukcionin e disa fragmenteve të shkurtra.
- Kërkojmë që në fshat të ketë më shumë kosha të vegjel mbeturinash.
- Kërkojmë vijëzimin e rrugës së re dhe vendosjen e tabelave për kufizim shpejtësie.

Kryeplaku i fshatit Moravë

- Kërkojmë vendosjen e filtrave në pusëtën e ujit pasi uji vjen me papastërti.
- Asfalti ekzistues është dëmtuar kërkon ndërhyrje.

VITHKUQ

- **Fshati Vithkuq:** Problem ngushtimi i rrugës së fshatit nga ndërtime të cilat kanë dalë jashtë projektit dhe si pasojë nuk kalojnë dot makinat, makina e mbeturinave nuk hyn dot në ato lagje, problem me ujin e vaditjes në stinën e verës.
- **Fshati Lubonjë:** Ujësjellësi në fshat ka dalë jashtë funksionit, zvendësimi I tjegullave të Kishës.
- **Fshati Panarit:** Kërkojmë asfaltimin e rrugës dhe pastrimin e kanaleve anësorë, vendosjen e disa tombinove.

- **Fshati Shtyllë:** Kërkojmë pastrimin e lumit me mjet me zinxhirë pasi fadroma nuk mund të hyjë.
- **Fshati Leshnjë:** Hapjen e shtratit të lumit dhe shtrimin e bazamentit me beton, vendosjen e ndriçuesve publikë.

Kryelaku i fshatit Vithkuq

- Problem me ngushtimin e rrugës së fshatit nga ndërtime të cilat kanë dalë jashtë projektit dhe si pasojë nuk kalojnë dot makinat, makina e mbeturinave nuk hyn dot në ato lagje
- Kërkojmë që firma e cila mbledh mbeturinat të na mundësojë një makinë më të vogël e cila të mund të hyjë në rrugët e ngushta.
- Kemi problem me ujin e vaditjes në stinën e verës.

Kryeplaku i fshatit Lubonjë

- Ujësjellësi në fshat ka dalë jashtë funksionit.
- Kërkojmë asfaltimin e rrugës së mbetur pa asfaltuar.
- Kërkojmë që makina e cila mbledh mbeturinat të vijë dy herë në javë dhe jo vetëm një herë në muaj siç vjen.
- Tjegullat e Kishës janë dëmtuar dhe duhet të zëvendësohen.
- Kërkojmë që të pajisemi me tokë nga toka e pa frutshme shtet për ndërtimin e stallave të bagëtive.
- Shtyllat e energjisë elektrike të zëvendësohen me shtylla betoni sepse janë shumë të dëmtuara.
- Çentrali të mos vendoset në funksion me ujin e rezervuarit.
- Kërkojmë të regjistrojmë pasuritë dhe të marrim certifikatat e pronësisë pasi gjithë këto vitë kemi probleme me ASHK.

Kryeplaku i fshatit Rehovë

- Kërkojmë asfaltimin e rrugës dhe pastrimin e kanaleve anësorë.

Kryeplaku i fshatit Panarit

- Kërkojmë pastrimin e kanaleve anësore të rrugës.
- Kërkojmë depozitimin e një sasive kripe në fshat në kohën e ngrices që shoferët ta hedhin vetë.
- Vendosjen e disa tombinove.

Kryeplaku i fshatit Shtyllë

- Kërkojmë pastrimin e lumit me mjet me zinxhirë pasi fadroma nuk mund të hyjë.

Kryeplaku i fshatit Leshnjë

- Kërkojmë hapjen e shtratit të lumit dhe shtrimin e bazamentit me beton
- Kërkojmë vendosjen e 4 koshave për mbeturina prej hekuri.
- Kërkojmë vendosjen e 4 ndriçuesve publike.
- Asfaltimin e 100 m rrugë tek varrezat.

VOSKOP

- **Fshati Voskop:** Shtrimin e rrugës së vjetër, shtrimin e rrugës së varrezave, zgjerimin e qendrës shëndetësore.
- **Fshati Vinçan:** Ndërhyrje në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza, asfaltim i rrugës Goskovë Poshtë – Vinçan.
- **Fshati Goskovë:** Mungon uji i pishëm dhe kërkohet ndërhyrje për rregullimin e urës në Goskovën Lart. Mungesë e ujit të pijshëm dhe ndërhyrje në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza.
- **Fshati Dërsnik:** Problem rritja e çmimit të ujit.
- **Fshati Damjanec:** Rregullim i urës lidhëse të fshatit.

- **Fshati Polenë:** Rregullimi i sheshit të fshatit.

Kryeplaku i fshatit Voskop

- Kërkojmë shtrimin e rrugës së vjetër.
- Shtrimin e rrugës së varrezave.
- Zgjerimin e qendrës shëndetësore.
- Çimentimin e kanaleve vaditëse.
- Rregullimin e fushës së sportit.
- Rritjen e çmimit të ujit nuk e përballojmë dot.
- Sistemimin e ujërave të zeza.
- Pajisjen e hyrjes së fshatit me ndriçues publikë.

Kryeplaku i fshatit Dërsnik

- Kemi problem me regjistrimin e tokave në ASHK.
- Problem me keqbërësit të cilët dëmtojnë hapësirat e përbashkëta.
- Rritja e çmimit të ujit është e papërballueshme.

Kryeplaku i fshatit Vinçan

- Problem me ujin e pijshëm, depozitat e ujit mbushen me batak.
- Gjatë periudhës së verës fshati nuk furnizohet me ujë të pijshëm gjatë gjithë ditës.
- Kërkojmë kanalizimin e ujërave të zeza.
- Kërkesë për vendosjen e disa ndriçuesve publikë në Vinçanin lart dhe poshtë.
- Kërkesë për vendosjen e disa kazanëve për mbeturina.
- Kontroll nga UKKO për lidhjet e paligjshme të ujit pasi mbetet fshati pa ujë.

Kryeplaku i fshatit Goskovë Poshtë

- Kemi problem me ujin e pijshëm pasi vjen vetëm një orë në ditë.
- Asfalti që nga lapidari deri brenda në Goskovë është prishur.
- Rruga që lidh Goskovën me Vinçanin kërkon investim.
- Në fushën e re të varrezave duhet të bëhen trotualet dhe të shtrohet rruga.
- Rregullimet e mureve rrethuese dhe kanalizimet.

- Problem me ujin e pishëm vjen me orar dhe cmimi i paperballueshëm.
- Kemi problem me AMTP nuk na dalin certifikatat e pronesisë.

Kryeplaku i fshatit Goskovë Lart

- Kemi mungesë të ujit të pijshëm.
- Kërkojmë kanalizimet e ujërave të zeza.
- Rikonstruksionin e pusetave të ujit të pijshëm.
- Linja e energjisë elektrike është shumë e dobët dhe kërkon ndërhyrje.
- Rregullimin e qendrës shëndetësore.
- Në Vasheiti rrezikon të bjerë zjarr pasi degët e pemëve kane arritur në telat e tensionit të lartë, rrezikon të digjet i gjithë mali.
- Problem me regjistrimin e pasurive.

Kreplaku i fshatit Polenë

- Rregullimi i sheshit të fshatit.

Kryeplaku i fshatit Damjanec

- Kërkojmë rikonstruksionin e urës së drurit në të cilën kalon i gjithë fshati.
- Zhvendosjen e lapidarit nga oborri i Xhamisë.

BULGAREC

- **Fshati Bulgarec:** Rregullimi i rrugës dhe sistemimi i trotuarëve.
- **Fshati Çiflig:** Shtrimi i rrugës së Manastirit.
- **Fshati Belorta:** Sistemim i ujërave të zeza.

- **Fshati Malavec:** Rikonstrukcionin e asfaltit pasi është dëmtuar.
- **Fshati Melçan:** Lidhjen e ujërave të zeza me kanalën kryesor.
- **Fshati Dishnicë:** Asfaltimin e rrugës së sipërme të fshatit.
- **Fshati Neviçisht:** Problem me ujin e pijshëm.

Kryelaku i fshatit Bulgarec

- Kemi problem me fundoret e ujërave të zeza pasi i kemi te dera e shtëpisë.
- Kërkojmë asfaltimin e rrugës së Xhamisë dhe SMT- së.
- Sistemimin e trotuarit në qendër të fshatit.
- Ndërtimin e palestrës së shkollës.
- Rregullimin e rrugës të Sadi Kodra.
- Probleme me ujin e pijshëm ka lidhje të paligjshme dhe çmimi është i paperballueshëm.

Kryelaku i fshatit Çiflig

- Kemi mungesë të energjisë elektrike.
- Kërkojmë shtrimin e rrugës së Manastirit.
- Rikonstrukcionin e Muzeumit.

Kryelaku i fshatit Belorta

- Kërkojmë sistemimin e ujërave të zeza pasi dalin tek shkolla e fshatit.
- Asfaltimin e mbetur në një pjesë të rrugës.

Kryelaku i fshatit Malavec

- Kërkojmë rikonstrukcionin e asfaltit pasi është dëmtuar.

Kryeplaku i fshatit Lumalas

- Asfaltimin e rrugës së fshatit.

Kryeplaku i fshatit Melçan

- Kemi problem me furnizimin me energji elektrike pasi linja e tensionit është e dobët
- Kërkojmë lidhjen e ujërave të zeza me kanalin kryesor
- Largimin e dherave nga rruga e parcelave
- Pastrimin e kanalit të Ventrokut
- Kemi mungesë të ujit të pijshëm

Kryeplaku i fshatit Dishnicë.

- Kërkojmë ndriçues publikë për rrugën anësore të fshatit
- Lagjia lart ka mungesë të tensionit të energjisë elektrike
- Kërkojmë asfaltimin e rrugës lart

Kryeplaku i fshatit Neviçisht

- Problem me UKKO pasi ka futur ujin e përroit në ujin e pishëm.

VOSKOPOJË

- **Fshati Voskopojë:** Investim ne shkollë dhe në kopësht për ngrohjen gjatë dimrit, shtimin e depove ujore.
- **Fshati Lekas:** Investim në rrugën e fshatit.
- **Fshati Lavdar:** Ndërtimin e qendrës shëndetësore.
- **Fshati Gjonomadh:** Asfaltimin e rrugës.
- **Fshati Lekas:** Asfaltimi i rrugës që lidh fshatin me Denasin.
- **Fshati Shkozanj, Gjokshtirë, Tudas:** Asfaltimin e rrugës.

Kryeplaku i fshatit Voskopojë

- Problem me rritjen e çmimit të ujit
- Kemi problem me ASHK duam të pajisemi me çertifikata pronësie
- Shumë banorë që kanë marrë leje ndërtimi kanë dalë jashtë projektit
- Kamionet që vijnë në fshat me materiale ndërtimi kanë prishur rrjetin e ujësjellësit
- Kërkojmë shtimin e depove të ujit pasi në periudhën e verës fshati mbetet pa ujë
- Kërkojmë që datat 23 – 24 qershor të bëhet festë për hapjen e sezonit veror.
- Kërkojmë hapjen e rrugëve nga dëbora edhe brenda fshatit jo vetëm rrugën kryesore
- Kërkojmë asfaltimin e rrugës Voskopojë – Lavdar
- Kërkesë për t'u pajisur me çertifikatë pasurie
- Problem me listën 01 në ASHK
- Kërkojmë shtimin e burimeve ujore sepse nuk kemi ujë
- Rikonstrukcionin e palestrës së shkollës
- Nuk e përballojmë dot rritjen e çmimit të ujit
- Kërkojmë disa kosha mbeturinash
- Linja e energjisë elektrike është shumë e dobët
- Kërkojmë që të zgjidhet problemi i ngrohjes në shkollë dhe në kopësht

Kryeplaku i fshatit Lekas

- Rruga e fshatit është amortizuar dhe ka nevojë për investim

Kryeplaku i fshatit Lavdar

- Kërkesë për vendosjen e disa tombinove në lumi i fshatit
- Kërkojmë të ndërtohet qendra shëndetësore sepse fshati nuk ka qendër
- Rregullimin e kalldrëmit të kishës
- Fadromë për pastrimin e kanaleve
- Kërkojmë asfaltimin e rrugës

Kryeplaku i fshatit Gjonomadh

- Kemi problem me ujin e pijshëm linja është e amortizuar ka nevojë për vendosjen e pusetave.
- Përfundimi i shtrimit të përroit me beton
- Kërkojmë asfaltimin e rrugës
- Kërkojmë disa kazanë mbeturinash
- Rrjetin e energjisë elektrike e kemi shumë të dobët

Kryeplaku i fshatit Lekas

- Kërkesë për ndriçues publik
- Problem me linjën e OSHEE është shumë e dobët.
- Kërkojmë të fillojnë punimet në rrugën e Denasit.
- Kërkojmë ndërhyrje në përroit Shkozanj – Gjokshtirë.
- Nevojitet furnizimi me ujë i shkollës.

Kryeplaku i fshatit Shkozanj-Gjokshtirë-Tudas

- Kërkesë për shtrimin e rrugës
- Kërkesë për përfundimin e rrugës së varrezave
- Kërkojmë restaurimin e Kishës së fshatit Tudas dhe rrethimin e varrezave

MOLLAJ

- **Fshati Mollaj:** Sistemimi i ujërave të zeza, sistemimi i argjinaturës së lumit.
- **Fshati Kamenicë:** Sistemim i ujërave të zeza.
- **Fshati Floq:** Sistemim i rrugëve të fshatit.
- **Fshati Pulahë:** Asfaltimin e rrugës dhe ndërtimi i urës.

Kryeplaku i fshatit Dvoran

- Cmimi i ujit është i papërballueshëm.
- Kemi problem me kanalizimet e ujërave të zeza pasi i kemi me gropë septike.

- Kërkojmë zëvendësimin e shtyllave të energjisë elektrike pasi ekzistueset janë të amortizuara.
- Ujërat e zeza janë në sipërfaqe.
- Sistemimi i argjinaturës së lumit.
- Restaurimi i pallateve dy katëshe.

Kryeplaku i fshatit Kamenicë

- Kemi problem me rritjen e çmimit të ujit është i papërballueshem.
- Në lagjen e mesit të gjitha ujërat e zeza dalin në rrugë.

Kryeplaku i fshatit Floq

- Kërkesë për sistemimin e disa rrugëve me stabilizant
- Asfaltimin e rrugës kryesore
- Shtrimin e rrugës së Kishës.

Kryeplaku i fshatit Kamenicë

- Shtrimi me asfalt i rrugës së Vakëfit
- Kërkojmë rrethimin e varezave
- Shtrimi me stabilizant i rrugëve të parcelave
- Vendosjen e ndriçimit publik në lagjen e cila nuk ka ndriçim
- Vendosjen e dy portave në lumi i fshatit

Kryeplaku i fshatit Pulahë

- Kërkesë për asfaltimin e rrugës
- Ndërtimin e urës.

NJËSIA ADMINISTRATIVE DRENOVË



NJËSITA ADMINISTRATIVE VITHKUQ



NJËSIA ADMINISTRATIVE VOSKOP



NJËSIA ADMINISTRATIVE BULGAREC



NJËSITË ADMINISTRATIVE VOSKOPOJË – LEKAS



NJËSIA ADMINISTRATIVE MOLLAJ



Përgjegjëse

Larisa Katundi